



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:116957
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05461847

CAJK.nr.32/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike jo kontestimore të propozuesit H.N, ndaj kundër propozueses F.P , për heqjen e zotësisë së veprimit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinikë CN.nr.193/23 e datës 25/01/2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e propozuesit H.N dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinikë CN.nr.193/23 e datës 25/01/2024 dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimi i ankimor CN.nr.193/23 e datës 25/01/2024, ka vendosur më sa vijon:

I. REFUZOHET si i pabazuar propozimi i propozuesit H.N, , për heqjen e zotësisë së veprimit ndaj kundërpropozueses F.P, e gjinisë N, nga babai B.N, për shkak të gjendjes së mirë shëndetësore psikike, gjegjësisht, të mosekzistimit të kushteve për t'iu marrur zotësia e veprimit kundërpropozueses.

II. Detyrohet propozuesi H.N, që kundërpropozueses F.N t'ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës, për të mbuluar mbrojtjen profesionale, në shumën prej 478,40 €.

Kundër këtij aktvendimi, i autorizuari i propozuesit në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta pranojë si të bazuar ankesën dhe të kthejë lëndën në rishqyrtim.

Kundër propozuesja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe nenin 209 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të propozuesit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi H.N, pranë gjykatës së shkallës së parë, me datën 24.05.2023, ndaj kundër propozueses ka paraqitur propozim për heqjen e zotësisë së veprimit me detaje si në propozim.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje juridike ka mbajtur seanca gjyqësore dhe ka marr aktvendimin e atakuar duke arsyetuar se në bazë të ekzaminimit të drejtëpërdrejtë të kundërpropozueses F.P në Klinikën Psikiatrike të S.P në Pejë me 16.06.2023, nga grupi i ekspertëve mjekësor Dr. M.H, psikiatër, Dr. N.P, psikiatër dhe V.M, psikologe, ekspertët kanë konstatuar se: *“ në bazë të ekzaminimit psikiatrik si dhe eksplorimit psikologjik të subjektit F.P, nuk vuan nga sëmundjet psiçike të lindura, si prapambetja mendore, dhe as nga sëmundjet psiçike të fituara, si ngathja mendore dhe çrregullimet psikotike. E din në përpikëri se çka posedon nga pasuria e saj dhe cilët janë trashëgimtarët e saj të ligjshëm...prandaj, konstatojnë se F.P është në gjendje të mirë psiçike për të mbrojtur të drejtat e saja juridike dhe deklaratimet e saja duhet të mirren parasys. Nuk duhet t'i merret zotësia e veprimit”, ndersa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka bazuar në dispozitën e nenit 48 të LPJK-së, nenit 449 të LPK-së dhe 452.1 të LPK-së, lidhur me nenin 3 të LPJK-së. Shuma e akorduar nga gjykata prej 478,40 €, në emër të shpenzimeve të procedurës, përfshinë kompensimin për përfaqësim të kundërpropozueses në dy seanca, 270,40 €, si dhe për përgjigje me shkrim në propozim 104 €, dhe për parashtresë për azhurim të çështjes 104 €, sipas TOAK-së, grupi tarifor 6 dhe 7. Ndërsa, për shpenzimet procedurale tashmë të përmbushura të propozuesit, që iu referohen pagesës për ekspertët, si dhe për taksë gjyqësore, ngelen gjithashtu në barrën e propozuesit. Të gjitha këto duke u mbështetur në rezultatin e shqyrtimit të kësaj çështje juridike jokontestimore dhe mbi bazën e këtyre arsyeve ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar duke u bazuar në nenin 31, 32, 33, 34, 37, 38, 40, 42, 46, dhe 48 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, lidhur me nenet 223 të Ligjit për Familjen të Kosovës, dhe lidhur me nenin 17 dhe 18 të LPJK-së, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 pika i) e lidhur me nenin 362.1, nenin 367 dhe nenin 453.1 të LPK-së, të cilat dispozita përshtatshmërisht zbatohen edhe në procedurën jo kontestimore konform nenit 3 të LPJK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se aktvendimi ankimor është përfshira me shkelje të dispozitave të lartcekura, për arsye se nuk ishte kontestuese fakti se gjykata e shkallës së parë ekspertizën mjekësore nga lëmia e psikiatrisë, ua ka dorëzuar palëve në seancën e datës 27/06/2023, ku i autorizuari i propozuesit ka deklaruar se nuk është në gjendje që të deklarohe lidhur me mendimin dhe konstatimin e ekspertizës mjekësore për arsye se nuk është dorëzuar me kohë dhe si rezultat ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore, të cilin propozim gjykata e shkallës së parë me të drejt e ka aprovuar si të bazuar në nenin 367 të LPK-së e cila dispozitë me nenin 24 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPK-së e ka ndryshuar nenin 367 të ligjit bazik, fjala “tetë (8) ditë” zëvendësohet me fjalën “shtatë (7) ditë” e cila normë juridike parasheh: *Gjykata ua dërgon palëve konstatimin dhe mendimin e*

shkruar së paku shtatë (7) ditë para se të filloj seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes. Qëllimi i kësaj dispozite është, që palëve t'u mundësohet njoftimi me rezultatin e ekspertimit dhe që ata të përgatiten për shqyrtimin e konstatimit dhe të mendimit të dhënë nga eksperti në seancën për shqyrtimin kryesor, si dhe eventualisht të përgatisin pyetje për ekspertin me qëllim të sqarimit, plotësimit apo të përmirësimit të konstatimit dhe të mendimit të tij, gjegjësisht në qoftë se palët kanë vërejtje në konstatimin dhe mendimin e ekspertit, ato vërejtjet duhet t'i paraqesin dhe t'i adresojnë në mënyrë të qartë, ashtu që në to të tregohet në mënyrë precize se në cilat pjesë apo në cilat aspekte konstatimi dhe mendimi i ekspertit janë të mangët ose janë dhënë në mënyrë jo- profesionale, apo janë në kundërshtim me të dhënat gjegjëse, ashtu që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë edhe përkundër asaj se e ka aprovuar propozimin për shtyrjen e seancës gjyqësore, megjithatë këtë dispozitë ligjore nuk e ka zbatuar e as nuk ka caktuar seancë tjetër kryesore dhe si rezultat ia ka pamundësuar propozuesit që të deklarohet lidhur me ekspertizën si dhe ia ka refuzuar propozimin që ekspertet të paraqiten në seancë dhe ky lëshim procedural ka pasur ndikim në ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar.

Prandaj, shkeljet e tilla të cekura më lartë përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që me rastin e shqyrtimit të çështjes, udhëzohet që të caktojë shqyrtimin përgatitorë/kryesor, ti ftoj palët ndërgjyqëse në mënyrë të rregullt si dhe t'iu mundësoj që të njëjtit ti paraqesin qëndrimet lidhur me ekspertizën mjekësorë si dhe të ftohet me rregull organi i kujdestarisë. Nëse palët kanë vërejtje lidhur me mendimin dhe konstatimin përfundimtarë të eksperteve mjekësor, atëherë në bazë të nenit 362.1 të LPK-së të ftoj grupin e eksperteve ose përfaqësuesin e tyre në seancë që të deklarohet lidhur me vërejtjet eventuale të palëve në raport me ekspertizën, pastaj gjykata e shkallës së parë duhet ti administroj provat e bashkangjitura në propozim si dhe ato të nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor si dhe lidhur me shpenzimet e procedurës jo kontestimore të vendos sipas nenit 453.1 të LPK-së, si dhe të vlerësoj të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qëllim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë duke përmbajtur udhëzimin mbi mjetin juridik siç e parashihet me nenin 46 i LPJK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CAJK.nr.32/24, me datë 12.03.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku